



**PARTIA SOCIALISTE E SHQIPËRISË
ASAMBLEJA KOMBËTARE**

PROJEKT V E N D I M

Nr. _____, datë 21.03.2026

PËR ZGJEDHJET E REJA NË STRUKTURAT VENDORE TË PARTISË.

Bazuar në Statutin e PS, neni 23, pika 6; neni 38, pika "f";
Asambleja Kombëtare e Partisë Socialiste

V E N D O S I :

Në periudhën 21 mars – 30 qershor 2026 të zhvillohen zgjedhjet në strukturat vendore në PS.

Fushata e zgjedhjeve në strukturat vendore të zhvillohet sipas këtyre fazave:

Faza përgatitore: 21 mars - 15 prill 2026, me këto veprimtari kryesore:

a. Mbledhjet e Asambleve Socialiste të bashkive për hapjen e fushatës së zgjedhjeve në strukturat vendore të partisë, të cilat miratojnë:

- Programin e punës për zbatimin e detyrave për zgjedhjet e reja.
- Strukturën organizative të partisë në bashki (KS dhe OS në përbërje të AS të bashkisë).
- Të deleguarit për çdo KS dhe OS për zgjedhjet e reja në parti.
- Ngritjen e OS të reja në QV të ngritura të reja për zgjedhjet e 11 Majit.
- Rritjen e anëtarësisë së partisë me objektiv që çdo OS të pranojë të paktën 4 anëtarë, 2 për çdo gjini.
- Ngritja e nukleve me të rinj të moshës 16-24 vjeç pranë çdo OS-je, antarë ose përkrahës të partisë.
- Takime me të rinjtë, antarë të nukleve, në nivel bashkie (shoqëruar me fotot përkatëse nga takimet)
- Të deleguarit të pasqyrojnë në vazhdimësi aktivitetin e kryer për plotësimin e detyrave më sipër në sistemin dixhital www.ps.al.

b. Në fazën përgatitore të deleguarit e AK të PS të marrin kontakte me OS përkatëse ku janë të deleguar për të bashkëbiseduar me anëtarësinë e partisë për situatën politike aktuale, për problematikat me të cilat përballen dhe gjendjen organizative të OS-ve.

Faza e parë:

Zgjedhjet në Organizatat Socialiste: 16 prill – 15 maj 2026

- Mbledhja zgjedhore e OS zhvillohet me pjesëmarrjen e domosdoshme të të deleguarit të AK të PS.
- Mbledhja konsiderohet e vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se 50 përqind plus 1 e numrit të anëtarëve të saj.
- Nga OS është plotësuar objektivi për të paktën 4 anëtarësimet e reja.
- Në mbledhjen zgjedhore të OS zhvillohet analiza për gjendjen organizative dhe rezultatin elektoral në zgjedhjet e 11 Majit.
- Mbledhja zgjedhore e OS zgjedh 2 bashkëkryetarët (një për secilën gjini), të cilët, si rregull, duhet të kenë të paktën një vit anëtarësi në parti; zgjedh sekretarin/sekretarët e OS; propozon e miraton me votim të hapur një kandidat për kryetar të KS të NJA, i cili të ketë jo më pak se 1 vit anëtarësi në parti. Grupet e anëtarëve të PS zgjedhin një sekretar.

Faza e dytë:

Zgjedhjet e kryetarëve të partisë të bashkive, 16 maj – 15 qershor 2026

- Kryesia e PS ngrre Komisionin e Posaçëm për përzgjedhjen e kandidatave për kryetar të partisë të bashkive të përbërë nga anëtarë të Kryesisë.
- Procesi i aplikimeve/propozimeve për kandidaturat për kryetar të partisë të bashkisë deri në zgjedhjen e tyre nga Kryesia e Partisë të kryhet bazuar në Rregulloren «*Strukturat organizative vendore të partisë*», nenet 11, 12.

Faza e tretë:

Konstituimi i organeve vendore të çdo niveli: KS të NJA, AS të bashkive, KKP të qarqeve. Deri 30 qershor 2026

Zgjedhjet në strukturat e partisë jashtë vendit.

Procesi zgjedhor të kryhet në zbatim të Vendimit «*Për riorganizimin e PS në diasporë*».

I gjithë procesi zgjedhor, nga faza përgatitore deri në konstituimin e strukturave vendore të partisë, të kryhet nën drejtimin dhe monitorimin e Drejtuesve Politikë të qarqeve.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Blendi KLOSI